



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 tetor 2024  
Nr. Ref.:RK 2553/24

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI172/24

Parashtrues

**Bariş (Mahfuz) Nakipoglu**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr.184/2024  
të 21 marsit 2024, të Gjykatës Supreme

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Bajram Ljatifi, gjyqtar  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Bariş (Mahfuz) Nakipoglu, shtetas i Turqisë i cili gjendet në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Hajvali (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Leutrim Sylja dhe Leutrim Himaj, avokatë në Komunën e Prishtinës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 184/2024] të 21 marsit 2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktvendimin [PN. nr. 157/2024] e 7 shkurtit 2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [PK. nr. 116/2022] e 29 dhjetorit 2023 të Gjykatës Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e kishte pranuar më 8 prill 2024.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kërkon edhe vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht anulimin e Vendimit [Nr. 99/2024], të 2 majit 2024, të Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin e tij nga Republika e Kosovës për në Republikën e Turqisë, me arsyetimin se ai, në rast të ekstradimit, rrezikon t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues, të ndaluar sipas nenit 3 (Ndalimi i torturës) të KEDNJ-së.

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 7 gusht 2024, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 13 gusht 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI172/24], caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI172/24], caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 20 gusht 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ministria e Drejtësisë) për regjistrimin e kërkesës.

10. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
11. Më 23 gusht 2024, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
12. Më 25 gusht 2024, Ministria e Drejtësisë dorëzoi komentet përkitazi me kërkesën.
13. Më 25 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

### **Përmbledhja e fakteve lidhur me procedurën penale të zhvilluar në Republikën e Turqisë kundër parashtruesit të kërkesës**

14. Më 4 dhjetor 2017, Gjykata Themelore Penale Nr. 5 e Karsiyaka në Izmir, përmes Vendimit [2017/912K], kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale “Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës” sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk, duke i shqiptuar dënim me 2 (dy) vite burgim. Më tej, Gjykata vëren se më 4 maj 2018 vendimi i lartcekur ishte bërë i formës së prerë dhe se më 10 shtator 2018 autoritetet kompetente të Turqisë lëshuan urdhër-arrest kundër parashtruesit të kërkesës.
15. Nga dosja e lëndës po ashtu rezulton se kundër parashtruesit të kërkesës ishte hapur procedura penale me shenjë [2021/161 Esas] pranë Gjykatës Themelore për Krimet e Rënda nr.3-Izmir si dhe procedura penale me shenjë [2020/500 Esas] pranë Gjykatës Themelore për Krimet e Rënda nr. 2-Stamboll, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope” nga neni 188/3 dhe “Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope” në bashkëkryerje, nga nenet 188/3 dhe 188/5 të Kodit Penal Turk, lidhur me të cilën është dorëzuar kërkesa e parë për ekstradim nga Ministria e Drejtësisë e Turqisë.
16. Siç rezulton nga dosja e rastit, parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor nga autoritetet gjyqësore turke për kryerjen e disa veprave penale, përkatësisht nga:
  - Gjykata Themelore e Krimeve të Rënda në Stamboll Nr. 5, për kryerjen e veprës penale “Vrasje e të afërmit të ngushtë”;
  - Gjykata Themelore Penale në Konya Nr. 8, për kryerjen e veprës penale “Vjedhje duke shpërdorur besimin” dhe
  - Gjykata Themelore Penale në Stamboll Nr. 42, për kryerjen e veprës penale “Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës”; dhe se i njëjti:
  - Kërkohet nga autoritetet e Turqisë për veprat penale “Falsifikim i dokumenteve zyrtare” nga neni 204/1 dhe “Vjedhje e sendit të vendosur në ruajtje” nga neni 142/1-B i Kodit Penal Turk.

### **Përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën në lidhje me kërkesat e para për ekstradim të zhvilluar para gjykatave të rregullta**

*Procedura lidhur me 2 (dy) kërkesat e para për ekstradim*

17. Më 5 korrik 2021 parashtruesi i kërkesës u arrestua nga autoritetet e Republikës së Kosovës, sipas urdhër-arrestit ndërkombëtar, përkritazi me procedurën penale me shenjë [2021/161 Esas] që ishte duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore për Krimet e Rënda nr.3-Izmir.
18. Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore për Krime të Rënda në Izmir si dhe Gjykata Themelore në Stamboll-Anadoll, parashtruan, përmes Ministrisë së Drejtësisë së Turqisë, kërkesat e tyre në Ministrinë e Drejtësisë për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës, për veprat penale “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” nga neni 188/3 dhe “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” në bashkëkryerje.
19. Më 6 gusht 2021, Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore), kishte parashtruar kërkesat [NJN. nr. 15/2021] dhe [NJN. nr. 20/2021], në Gjykatën Themelore për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” nga neni 188/3 dhe “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” në bashkëkryerje, nga nenet 188/3 dhe 188/5 të Kodit Penal Turk, e paraparë po ashtu me nenin 267 “*Blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*” të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (i publikuar në Gazetën Zyrtare më 14 janar 2019) (në tekstin e mëtejme: KPRK).
20. Më 11 gusht 2021, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PK. nr. 117/21], (i) aprovoi kërkesat [NJN. nr. 15/2021] dhe [NJN. nr. 20/2021] e Prokurorisë Themelore për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës; (ii) njoftoi Ministrinë e Drejtësisë se ndaj parashtruesit të kërkesës është duke u zhvilluar procedurë penale pranë Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me shenjë PP/I/ nr. 148/2021, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “*Falsifikimi i dokumentit zyrtar*” nga paragrafi 1 i nenit 427, “*Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes*” nga neni 336 dhe “*Legalizimi i përmbajtjes së rreme*” nga neni 395 i KPRK-së; si dhe (iii) vazhdoi masën e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës deri në ekstradimin e tij, përkatësisht deri në përfundimin e procedurave administrative-diplomatike ndërmjet dy shteteve. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore u theksua se (i) janë plotësuar kushtet ligjore për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës, të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale (i publikuar në Gazetën Zyrtare më 2 shtator 2013) (në tekstin e mëtejme: Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale); dhe se (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka shtetësinë e Republikës së Kosovës por të Turqisë dhe se i njëjti dokumentet e tij identifikuese të Republikës së Kosovës me inicialet [I.F] i ka të rreme dhe të vjedhura, për çka është hapur procedura penale pranë Prokurorisë Themelore në Pejë.
21. Nga shkresat e lëndës rezulton se Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Themelore është vërtetuar përmes Aktvendimit [PN. nr. 784/2021] të 24 gushtit 2021 të Gjykatës së Apelit dhe se më 13 shtator 2021, Ministria e Drejtësisë përmes Vendimit [Nr. 130/2021] lejoi ekstradimin e parashtruesit të kërkesës për në Republikën e Turqisë. Megjithatë, ekstradimi ishte shtyrë deri në përfundimin e gjykimit dhe vuajtjes së plotë të dënimit që mund të shqiptohej ndaj tij në Republikën e Kosovës.

*Procedura lidhur me kërkesën e tretë për ekstradim*

22. Nga komentet e Ministrisë së Drejtësisë të dorëzuara në Gjykatë rezulton se, më 12 gusht 2021, Ministria e Drejtësisë së Turqisë dorëzoi në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën e Prokurorisë së Stambollit, Zyrës së njoftimit dhe ekzekutimit të vendimeve penale, për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës. Ky i fundit, në bazë të kërkesës për ekstradim, kërkohej nga Gjykata Themelore e Krimeve të Rënda në Stamboll Nr. 5 për kryerjen e veprës penale “*Vrasje e të afërmit të ngushtë*”; Gjykata Themelore Penale në Konya Nr. 8 për kryerjen e veprës penale “*Vjedhje duke shpërdorur besimin*” dhe nga Gjykata Themelore Penale në Stamboll Nr. 42 për kryerjen e veprës penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*”.
23. Më 27 gusht 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PK. nr. 124/2021] lejoi ekstradimin e parashtruesit të kërkesës për në Turqi me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore për ekstradim sipas Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër këtij Aktvendimi u refuzua nga Gjykata e Apelit, më 3 prill 2024, ku kjo e fundit përmes Aktvendimit [PN. Nr. 500/2024] e vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.
24. Bazuar në komentet e Ministrisë së Drejtësisë, kjo e fundit ka nxjerrë vendim përmes së cilit ka dhënë pëlqim për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës.

***Procedura përkritazi me kërkesën e katërt për ekstradim dhe procedurën e zhvilluar para gjykatave të rregullta dhe që kontestohet nga parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës***

25. Më 8 prill 2022, Ministria e Drejtësisë së Turqisë dorëzoi në Ministrinë e Drejtësisë kërkesën e katërt për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës me qëllim të vuajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar nga Gjykata Themelore Penale Nr. 5 e Karsiyaka në Izmir, për kryerjen e veprës penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk.
26. Më 14 korrik 2022, Prokuroria Themelore, parashtrroi kërkesën [NJN.nr.20/22] në Gjykatën Themelore për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës në Turqi për vuajtje të dënimit për shkak të veprës penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*”, sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk, e paraparë me nenin 313 “*Vjedhja*” të KPRK-së.
27. Më 28 korrik 2022, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PK.nr.116/2022], aprovoi kërkesën [NJN. nr. 20/22] e Prokurorisë Themelore dhe lejoi ekstradimin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore arsyetoi se (i) ishin plotësuar kushtet ligjore për ekstradim, të përcaktuara me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale; si dhe (ii) refuzoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ekzekutimi i dënimit me burgim në rastin e tij ishte parashkruar, me arsyetimin se në njoftimin e shtetit kërkuar ishte cekur që afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit të tij parashihej deri në 10 (dhjetë) vite, dhe se gjithashtu sipas pikës 1.5 të paragrafit 1 të nenit 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve) i Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (GZ, numër 19, 13 korrik 2022) (në tekstin e mëtejshëm: KPRK i vitit 2012), në fuqi në kohën kur i ishte shqiptuar, parashihej “*afati i parashkrimit prej 3 vite dhe dyfishi i këtij afati në 6 vite*”.
28. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar, mes

- tjerash, se (i) ekzekutimi i dënimit është parashkruar sipas pikës 1.5 të paragrafit 1 të nenit 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve) të KPRK-së së vitit 2012; dhe (ii) seanca dëgjimore nuk ishte mbajtur brenda afatit të paraparë prej 3 (tre) ditësh.
29. Më 12 gusht 2022, Prokuroria e Apelit në Prishtinë, përmes parashtresës [PPN/I. nr. 302/22] i propozoi Gjykatës së Apelit që të refuzojë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të vërtetojë Aktvendimin [PK. nr. 116/2022] e 28 korrikut 2022 të Gjykatës Themelore.
  30. Më 15 gusht 2022, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN. nr. 845/2022] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [PK. nr. 116/2022] e 28 korrikut 2022 të Gjykatës Themelore, duke arsyetuar se janë përmbushur kushtet e përcaktuara me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale dhe me Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi Ekstradimin (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja Dypalëshe mbi Ekstradimin), pasi (i) parashtruesi i kërkesës është dënuar me 2 (dy) vite burgim me aktgjykim të formës së prerë për veprën penale “Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës” sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk, e paraparë edhe me nenin 313 “Vjedhja” të KPRK-së; (ii) Ministria e Drejtësisë e Republikës së Turqisë përmes Ministrisë së Drejtësisë ka parashtruar kërkesë për ekstradimin e tij, kërkesë të cilës i janë bashkëngjitur dokumentet e nevojshme së bashku me garancitë e ofruara përfshirë respektimin e rregullit të specialitetit; (iii) ekzekutimi i dënimit me burgim të parashtruesit të kërkesës nuk është parashkruar me asnjërin nga ligjet e dy shteteve; dhe se (iv) pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me seancën dëgjimore nuk kanë shkaktuar humbjen e një të drejte apo cenimin nga e drejta në mbrojtje efektive.
  31. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të gjykatave të shkallës më të ulët, duke pretenduar shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.
  32. Më 7 tetor 2022, Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Prokurori i Shtetit), përmes parashtresës [KMLP. III. nr. 229/2022], propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
  33. Më 8 nëntor 2022, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 377/2022] (i) miratoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi Aktvendimin [PK. nr. 116/2022] e 28 korrikut 2022 të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimin [PN. nr. 845/2022] e 15 gushtit 2022 të Gjykatës së Apelit; dhe (iii) çështjen e ktheu në shkallë të parë për rivendosje. Gjykata Supreme vlerësoi se arsyetimi i gjykatave të shkallës më të ulët nuk është i qartë sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të dënimit pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të konkludohet nëse nga nxjerrja e urdhër-arrestit më 10 shtator 2018 deri në paraqitjen e kërkesës për ekstradim në vitin 2022, është ndërprerë me ndonjë veprim rrjedhja e afatit të parashkrimit relativ të ekzekutimit të dënimit. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme theksoi se gjykata e shkallës së parë, në përputhje me Ligjin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, duhet të paraqesë kërkesë për informata shtesë nga autoritetet turke përmes Ministrisë së Drejtësisë dhe që pas pranimit të tyre të vazhdojë me nxjerrjen e vendimit.
  34. Më 29 dhjetor 2023, Gjykata Themelore, duke vepruar në rigjykim, përmes Aktvendimit [PK. nr. 116/2022] aprovoi kërkesën [NJN. nr. 20/22] e Prokurorisë Themelore dhe lejoi

ekstradimin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore theksoi se nga autoritetet turke vërtetohej se urdhër-arresti ndaj parashtruesit të kërkesës ishte lëshuar me 10 shtator 2018, se nuk kishte ndërprerje të këtij urdhër-arresti dhe se parashkrimi lidhur me veprën penale për të cilën ishte dënuar i njëjti nuk kishte arritur. Rrjedhimisht, në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore u theksua se ishin plotësuar kushtet ligjore për ekstradim, gjegjësisht që (i) parashtruesi i kërkesës nuk hyn në grupin e personave që kanë statusin e azilit politik apo refugjatit politik; (ii) vepra penale nuk është kryer në territorin e Republikës së Kosovës dhe as kundërt shtetasit të saj; (iii) vepra penale për të cilën është kërkuar ekstradimi është e paraparë sipas KPRK-së; (iv) nuk ka parashkrim të ekzekutimit të sanksionit penal; dhe (v) parashtruesi i kërkesës nuk kërkohet për vepra penale politike, vepra penale ushtarake dhe vepra penale për të cilat parashihet dënimi me vdekje ose me burgim të përjetshëm.

35. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën e Apelit ankesë kundër Aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se (i) Gjykata Themelore nuk i ishte përmbajtur udhëzimeve të Gjykatës Supreme, përkatësisht nuk kishte verifikuar nëse kishte pasur veprim tjetër procedural përveç urdhër-arrestit të 10 shtatorit 2018; (ii) parashkrimi i ekzekutimit të dënimit të tij ishte arritur me 2 janar 2022; (iii) pas dorëzimit tek autoritetet turke ai do t'i nënshtrohet torturës; dhe se (iv) kërkesa e tij për azil është aprovuar.
36. Më 30 janar 2024, Prokuroria e Apelit, përmes parashtrësës [PPN/I. nr. 55/24] i propozoi Gjykatës së Apelit që të refuzojë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të vërtetojë Aktvendimin [PK. nr. 116/2022] e 29 dhjetorit 2023 të Gjykatës Themelore.
37. Më 7 shkurt 2024, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN. nr. 157/2024] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [PK. nr. 116/2022] e 29 dhjetorit 2023 të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit konstatoi se (i) sipas legjislacionit turk, parashkrimi i ekzekutimi të dënimit të shqiptuar kundër parashtruesit të kërkesës nuk kishte arritur; (ii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës se pas ekstradimit do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimit është i pabazuar pasi që i njëjti nuk i takon një grupi të caktuar shoqëror dhe nuk është person i kërkuar për vepra politike, vepra penale ushtarake apo vepra penale për të cilat parashihet dënimi me vdekje ose burgim të përjetshëm; dhe (iii) refuzoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës se i është aprovuar kërkesa për azil me arsyetimin se kërkesa e tij ishte kthyer në shkallën e parë për rishqyrtim dhe se ende nuk kishte vendim të formës së prerë nga organi administrativ.
38. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të instancave më të ulëta, duke pretenduar shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.
39. Më 19 mars 2024, Prokurori i Shtetit, përmes parashtrësës [KMLP. III. nr. 76/24], propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
40. Më 21 mars 2024, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 184/2024], refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyetimin se (i) janë plotësuar kushtet ligjore për ekstradim sipas Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale; (ii) parashkrimi i ekzekutimit të dënimit nuk është arritur sipas legjislacionit turk

dhe as sipas pikës 1.5 të paragrafit 1 të nenit 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve) dhe paragrafit 6 të nenit 110 (Fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit) të KPRK-së së vitit 2012, në fuqi kur Aktgjykimi kishte marrë formën e prerë; dhe se (iii) nuk ka parashkrim relativ të ekzekutimit të dënimit sipas paragrafit 3 të nenit 107 (Fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale) të KPRK-së së vitit 2012, pasi që afati i parashkrimit nuk rrjedh gjatë kohës kur kryerësi kërkohet me urdhër-arrest.

#### *Procedura lidhur me kërkesën e pestë për ekstradim*

41. Nga shkresat e lëndës rezulton se në fund të vitit 2023, Ministria e Drejtësisë së Turqisë parashtrroi në Ministrinë e Drejtësisë kërkesë për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës, i kërkuar nga autoritet turke lidhur me veprën penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas Kodit Penal Turk.
42. Më 4 mars 2024, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PK.nr.2/2024] lejoi ekstradimin e parashtruesit të kërkesës për në Turqi me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore për ekstradim. Ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër këtij Aktvendimi u refuzua nga Gjykata e Apelit, më 3 prill 2024, ku kjo e fundit përmes Aktvendimit [PN. Nr. 500/2024] e vërtetoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Bazuar në komentet e Ministrisë së Drejtësisë, kjo e fundit ka nxjerrë vendim përmes së cilit ka dhënë pëlqim për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës.

#### **Procedura përkitazi me dhënien e pëlqimit të Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës**

43. Më 2 maj 2024, Ministria e Drejtësisë përmes Vendimit [Nr. 99/2024] vendosi që (i) të japë pëlqimin për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës për në Turqi, për shkak të veprave penale “*Falsifikim i dokumenteve zyrtare*” nga neni 204/1 dhe “*Vjedhje e sendit të vendosur në ruajtje*” nga neni 142/1-B të Kodit Penal Turk, të dënueshme edhe sipas KPRK-së, sipas Aktvendimit [PK. nr. 2/2024] të Gjykatës Themelore; (ii) pëlqimi jepet nën kushtet e përcaktuara në nenin 22 të Marrëveshjes Dypalëshe mbi Ekstradimin dhe nenin 17/A të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale (publikuar në Gazetën Zyrtare më 26 prill 2022).
44. Më 3 maj 2024, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë, përmes shkresës [MD/DBGJ/1827/B/mk/DBJN/2021/857], njoftoi Gjykatën Themelore me Vendimin [Nr. 99/2024] për dhënien e pëlqimit për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës.
45. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative padi për anulimin e Vendimit [Nr. 99/2024] të 2 majit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të tij, me arsyetimin se (i) janë plotësuar kushtet e përcaktuara me paragrafët 2 dhe 6 të nenit 22 (Pa titull) të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (GZ, numër 82, 21 tetor 2010) (në tekstin e mëtejme: LKA); (ii) në rast të ekstradimit, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues; dhe (iii) do t'i cenohet e drejta për jetë.
46. Më 24 maj 2024, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktvendimit [A. nr. 1980/2024] refuzoi kërkesën e parashtruesit të



kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit [Nr. 99/2024] të 2 majit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë drejtim, sipas kësaj gjykate, nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet e përcaktuara në nenin 22 të LKA-së lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit pasi që pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk janë argumentuar me prova konkrete dhe bindëse.

47. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [A. nr. 1980/2024] të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me arsyetimin se, për shkak të përkatësisë në grupin "FETO/PDY", në rast të zbatimit të vendimit për ekstradim, i njëjti do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor, poshtërues dhe degradues.
48. Më 13 qershor 2024, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 574/2024] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [A. nr. 1980/2024] e 24 majit 2024 të Gjykatës Themelore, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Gjykata e Apelit vlerësoi se parashtruesi i kërkesës nuk paraqiti argumente bindëse për të mbështetur pretendimin e lartcekur, duke arsyetuar se (i) i njëjti kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare pranë autoriteteve të vendit 5 (pesë) vite pas hyrjes në Republikën e Kosovës, përkatësisht pas arrestimit të tij nga policia; dhe (ii) parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar prova të mjaftueshme për plotësimin e kushteve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit sipas nenit 22 (Pa titull) të LKA-së, pasi që i njëjti kishte ofruar prova që ndërlidhen me kërkesën kryesore për anulimin e vendimit të kontestuar dhe jo shtyrjen e ekzekutimit të tij.

**Përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën e azilit dhe kryerjen e veprës penale "Legalizim i përmbajtjes së rreme" sipas paragrafit 2 lidhur me paragrafin 1 të nenit 395 të KPRK-së, të kryer në Kosovë**

49. Më 4 maj 2023, Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore në Pejë), përmes Aktgjykimit [P. nr. 884/21] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale "Legalizim i përmbajtjes së rreme" sipas paragrafit 2 lidhur me paragrafin 1 të nenit 395 të KPRK-së, duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dënim ky i cili me pëlqimin e parashtruesit të kërkesës mund t'i zëvendësohej në dënim me gjobë në shumën prej 2000 (dy mijë) euro.
50. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 29 maj 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim) aplikacion për mbrojtje ndërkombëtare.
51. Më 19 korrik 2023, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i Ministrisë së Drejtësisë, përmes shkresës [MD/DBGJ/2355/MK/23/DBJN/2021/857] njoftoi parashtruesin e kërkesës se ishte vënë në dijeni lidhur me procedurën penale që ishte duke u zhvilluar pranë Prokurorisë Themelore në Pejë, me procedurën e azilit dhe se dorëzimi i tij tek autoritetet e Turqisë shtyhej deri në përfundim të gjykimit dhe vuajtjes së plotë të dënimit që mund t'i shqiptohej.
52. Më 15 shtator 2023, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, përmes Vendimit [Nr. Ref. 6523] refuzoi aplikacionin e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe nuk i njohu cilësinë e refugjatit. Ndër të tjera, duke iu referuar nënparagrafit 8 të paragrafit 1 të nenit 63 (Aplikacioni i pabazuar) si dhe neneve 61 (Vendimi i shkallës së parë) dhe 62

- (Refuzimi i aplikacionit) të Ligjit Nr. 06/L-026 për Azil (GZ, numër 8, 15 maj 2018) (në tekstin e mëtejme: Ligji për Azil), Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk e përmbushë përkufizimin e refugjatit, se i njëjti kishte aplikuar për azil 5 (pesë) vite pas hyrjes në territorin e Republikës së Kosovës dhe vetëm pasi që ishte kapur nga autoritetet policore për falsifikim të dokumenteve dhe qëndrim të parregullt.
53. Më 5 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesën [Nr. 102] në Komisionin Kombëtar për Refugjatë të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Komisioni Kombëtar për Refugjatë) kundër Vendimit të lartcekur të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim.
  54. Më 3 nëntor 2023, Komisioni Kombëtar për Refugjatë përmes Vendimit [KKR. Nr. 05/2023] (i) aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; (ii) anuloi Vendimin [Nr. Ref. 6523] e 15 shtatorit 2023 të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim; dhe (iii) ktheu çështjen për rishqyrtim në shkallë të parë.
  55. Më 21 shkurt 2024, në rivendosje, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, përmes Vendimit [Nr. Ref. 6523] refuzoi aplikacionin e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare dhe nuk i njohu cilësinë e refugjatit. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim vlerësoi se parashtruesit të kërkesës nuk mund t'i njihet statusi i refugjatit me arsyetimin se pjesëmarrja e tij në një protestë kundër mbylljes së një gazete dhe mbajtja e tij për 3 (tre) ditë nuk janë të mjaftueshme për nga intensiteti për t'u kualifikuar për status të refugjatit. Gjithashtu, në arsyetimin e këtij vendimi u theksua se nuk mund të merret në konsideratë Vendimi për kapje me qëllim arrestimi për veprën penale "*Pjesëtar i organizatës së armatosur terroriste*" pasi që e njëjta është në kundërshtim me profilin dhe veprimet për të cilat është kërkuar ekstradimi i parashtruesit të kërkesës si dhe nuk ka qenë pjesë e aktiviteteve politike apo strukturave organizative politike.
  56. Më 11 mars 2024, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesën [Nr. 05] në Komisionin Kombëtar për Refugjatë kundër Vendimit të lartcekur të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave materiale.
  57. Më 3 prill 2024, Komisioni Kombëtar për Refugjatë përmes Vendimit [KKR. Nr. 08/2024] (i) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; (ii) la në fuqi Vendimin [Nr. Ref. 6523] e 21 shkurtit 2024 të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim; dhe (iii) vendosi që parashtruesi i kërkesës duhet ta lëshojë vendin brenda 30 (tridhjetë) ditë nga dita e pranimit të vendimit. Komisioni Kombëtar për refugjatë vlerësoi se vendimi i organit të shkallës së parë është i bazuar në legjislacionin në fuqi dhe se drejtë është konstatuar gjendja faktike. Në këtë aspekt, duke iu referuar nënparagrafit 7 të paragrafit 1 të nenit 63 (Aplikacioni i pabazuar) të Ligjit për Azil, konstatoi se aplikacioni i parashtruesit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare është dorëzuar me qëllim që të shmangë ekstradimin, marrë parasysh faktin se i njëjti gjendet brenda territorit të Republikës së Kosovës që nga viti 2018 mirëpo aplikacionin në fjalë e ka dorëzuar me 29 maj 2023, pas arrestimit nga policia dhe fillimit të procedurave të ekstradimit.
  58. Më 25 prill 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi për inicimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kundër Vendimit [KKR. Nr. 08/2024] të 3 prillit 2024 të Komisionit

Kombëtar për Refugjatë, për shkak të shkeljes së të drejtës materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

59. Më 26 prill 2024, parashtruesi i kërkesës njoftoi Ministren e Drejtësisë dhe Departamentin për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar të Ministrisë së Drejtësisë për dorëzimin e padisë pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe i kërkoi që të pezullohet procedura e ekstradimit deri në marrjen vendimit të formës së prerë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

60. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 184/2024], të 21 marsit 2024, të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
61. Parashtruesi i kërkesës, në thelb, para Gjykatës pretendon se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm i është shkelur si rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit dhe mungesës së arsytimit të vendimeve gjyqësore nga ana e gjykatave të rregullta.
62. Përkitazi me pretendimin për zbatim të gabuar të ligjit, parashtruesi i kërkesës thekson se edhe pse sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe Gjykatës, nuk është detyrë e kësaj të fundit që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që mund të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, e njëjta duhet të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në atë mënyrë që mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës i referohet rasteve të Gjykatës [KI10/19](#), parashtruese e kërkesës *Besarta Maloku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019; dhe [KI195/20](#), parashtrues i kërkesës *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim i 29 marsit 2021; si dhe rastit të GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999.
63. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar, Gjykata Supreme i është referuar gabim paragrafit 3 të nenit 107 (Fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale) të KPRK-së së vitit 2012, meqenëse kjo dispozitë rregullon afatin e parashkrimit të ndjekjes penale dhe jo afatin e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, lidhur me të cilin kërkohet parashtruesi i kërkesës nga autoritetet turke. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës shton se përmes vendimeve të tyre, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk e kanë arsyetuar parashkrimin e ekzekutimit të dënimit në kuptim të nenit 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve) të KPRK-së së vitit 2012, por është mjaftuar me deklarimin se në bazë të informatave të pranuar nga autoritetet turke, parashkrimi për ekzekutimin e dënimit sipas ligjit në Turqi për veprën penale në fjalë është 10 (dhjetë) vite. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është ndërprerë afati i parashkrimit pasi që autoritetet turke kishin ndërmarrë veprim procedural më 2 janar 2019, dhe rrjedhimisht, sipas tij, dënimi i shqiptuar ndaj tij ka arritur parashkrimin relativ sipas KPRK-së së vitit 2012, më 8 prill 2022. Sipas parashtruesit të kërkesës, konstatimi i Gjykatës Themelore se kërkesa e tij për azil është refuzuar pasi që i njëjti nuk mund të gëzojë të drejtën e azilit është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut pasi që për të drejtën e azilit vendosë Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim dhe jo gjykata që ka në shqyrtim çështjen penale.

64. Lidhur me pretendimin për mungesë të arsytimit të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës thekson se e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor, përmes së cilit përveç që u dëshmohet palëve në procedurë që janë dëgjuar, realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës i referohet rastit të Gjykatës [KI72/12](#), parashtrues i kërkesës *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012; si dhe rastit të GJEDNJ-së [Ruiz Toria kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994.
65. Parashtruesi i kërkesës shton se meqenëse kërkesa e tij për mbrojtje ndërkombëtare, përkatësisht kërkesa për azil, është në procedurë para Gjykatës Themelore dhe mund të zgjasë me vite, atij duhet t'i zëvendësohet masa e paraburgimit që i është shqiptuar përmes Aktvendimit [PK. nr. 117/21] të 11 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore, me një masë më të butë ose me qëndrim në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan.
66. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nuk është trajtuar çështja substanciale, përkatësisht afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit i paraparë me nenin 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit) të KPRK-së që ishte në fuqi kur aktgjykimi i gjykatës përkatëse në Turqi ishte bërë i formës së prerë. Sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se sipas kësaj dispozite dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet pas 3 (viteve) nga dënimi me mbi 1 (një) vit burgim, dhe që sipas paragrafit 6 të nenit 110 (Fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit) të KPRK-së së vitit 2012, parashkrimi i ekzekutimit të dënimit në çdo rast ndalohet kur të ketë kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës shton se përmes mosarsytimit të afatit të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit si pretendim thelbësor i tij dhe duke mos iu referuar provave dhe fakteve që gjenden në shkresat e lëndës, Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk i përmbushë kriteret e një vendimi të arsyetuar gjyqësor dhe rezulton në konkluzione arbitrare dhe qartazi të paarsyeshme për të.
67. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës po ashtu kërkon vendosjen e masës së përkohshme ndaj Vendimit [Nr. 99/2024], të 2 majit 2024, të Ministrisë së Drejtësisë përmes së cilit është dhënë pëlqimi për ekstradimin e tij në Turqi, sipas Aktvendimit [PK. nr. 2/2024] të 4 marsit 2024 të Gjykatës Themelore, lidhur me veprat penale "*Falsifikim i dokumenteve zyrtare*" nga neni 204/1 dhe "*Vjedhje e sendit të vendosur në ruajtje*" nga neni 142/1-B të Kodit Penal Turk, të dënueshme edhe sipas KPRK-së. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se vendimi në fjalë fare nuk ka përmendur procedurën e azilit, edhe pse Ministria e Drejtësisë ishte në dijeni për të.
68. Sipas parashtruesit të kërkesës, ekstradimi i tij në Turqi paraqet shkelje të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 17 (Klauzola jodiskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut) të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale që ndalojnë ekstradimin kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se personi i kërkuar mund t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimit apo kur mund të ketë shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe standardeve tjera të të drejtave të njeriut. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës shton se ekstradimi në fjalë shkel nenin 5 (Ndalimi i dëbimit ose i kthimit (Non -refoulement)) të Ligjit për Azil, me arsytimin se i njëjti ndalon dëbimin apo kthimin e aplikuesit në kufijtë e territorit ku do t'i kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.

69. Parashtruesi i kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohshme me arsyetimin se në rast të ekstradimit në Turqi, ai rrezikon t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues, të ndaluar me nenin 3 (Ndalimi i torturës) të KEDNJ-së, si rezultat i përkatësisë së tij në grupin shoqëror të njohur si “*FETO/PDY*” dhe pjesëmarrjes së tij në protestën e kësaj organizate pranë një gazete, gjë për të cilën ishte ndaluar nga policia turke. Përkitazi me pretendimin për rrezikun potencial në rast të ekstradimit, parashtruesi i kërkesës i referohet një sërë raporteve ndërkombëtare dhe rasteve të GJEDNJ-së [Ozdil dhe të tjerët kundër Republikës së Moldavisë](#), nr. 42305/18, Aktgjykim i 11 shtatorit 2019; [Tarakhel kundër Zvicrës](#), nr. 2917/12, Aktgjykim i 4 nëntorit 2014; [Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 14038/88, Aktgjykim i 7 korrikut 1989; dhe [M.S.S kundër Belgjikës dhe Greqisë](#), nr. 30696/09, Aktgjykim i 21 janarit 2011.
70. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) ta shpallë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (iii) ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Pml. nr. 184/2024] e 21 marsit 2024 të Gjykatës Supreme; (iv) ta anulojë Vendimin [Nr. 199/2024] e 2 majit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë për ekstradim deri në nxjerrjen e një vendimi përfundimtar në procedurë të azilit; dhe (v) të shpallë se ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

### **Komentet e Ministrisë së Drejtësisë**

71. Më 25 gusht 2024, Ministria e Drejtësisë dorëzoi në Gjykatë komente përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të cilave u bashkëngjiti vendimet e gjykatave të rregullta lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit [Nr. 99/2024] të Ministrisë së Drejtësisë dhe Aktgjykimin [P. nr. 884/2023] të 3 majit 2023 të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm.
72. Ministria e Drejtësisë theksoi se parashtruesi i kërkesës është arrestuar më 5 korrik 2021 nga policia e Republikës së Kosovës mbi bazën e urdhër-arrestit ndërkombëtar të lëshuar nga Interpol. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, pas arrestimit të parashtruesit të kërkesës, Ministria e Drejtësisë e Turqisë parashtrroi pranë kësaj Ministrie 5 (pesë) kërkesa për ekstradimin e tij.
73. Më tej, Ministria e Drejtësisë shton se më 8 prill 2022, Ministria e Drejtësisë së Turqisë transmetoi kërkesën katërt për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës me qëllim të vuajtjes së dënimit me burgim të shqiptuar nga Gjykata Themelore Penale Nr. 5 e Karsiyaka në Izmir, për kryerjen e veprës penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk. Përkitazi me këtë kërkesë, më 28 korrik 2022, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PK.nr.116/2022] lejoi ekstradimin e parashtruesit të kërkesës, aktvendim i cili u vërtetua më 15 gusht 2022, nga Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PN. nr. 845/2022]. Ministria e Drejtësisë thekson se aktvendimet e lartcekura u anuluan nga Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Pml. nr. 377/2022] duke e kthyer çështjen në rivendosje. Sipas komenteve të Ministrisë së Drejtësisë, në rivendosje Gjykata Themelore, sërish, lejoi ekstradimin, vendim të cilin e vërtetoi më pas Gjykata e Apelit dhe në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 184/2024] i cili kontestohet para Gjykatës nga parashtruesi i kërkesës.
74. Ministria e Drejtësisë përmes komenteve të saj informon Gjykatën se kërkesa e fundit e autoriteteve turke për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës është paraqitur në fund të

vitit 2023, lidhur me veprat penale “Falsifikim i dokumenteve zyrtare” nga neni 204/1 dhe “Vjedhje e sendit të vendosur në ruajtje” nga neni 142/1-B të Kodit Penal Turk. Në lidhje me këtë kërkesë, Ministria e Drejtësisë shton se Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PK. nr. 2/2024], ka lejuar ekstradimin e tij, vendim ky i cili u vërtetua përmes Aktvendimit [PN. nr.500/2024] të Gjykatës së Apelit dhe, në vazhden e të cilëve, Ministria e Drejtësisë përmes Vendimit [Nr. 99/2024] dha pëlqimin për ekstradimin e tij.

75. Ministria e Drejtësisë, para Gjykatës, pretendon se veprat penale për të cilat kërkohet parashtruesi i kërkesës nga autoritetet e Turqisë, si për vuajtje të dënimit ashtu edhe për ndjekje penale, nuk janë vepra politike dhe as nuk ndërlidhen me to si dhe i njëjti kërkohet për veprat penale të lartcekura dhe jo për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë dhe gjuhës. Në këtë drejtim, Ministria e Drejtësisë shton se Interpol refuzon shpalljen në kërkim ndërkombëtar të personave të kërkuar nga Turqia që janë pjesëtarë të lëvizjes “Feto”, përderisa në rastin e parashtruesit të kërkesës i njëjti është në listën e të kërkuarve në Interpol.
76. Në komentet e dorëzuara në Gjykatë, Ministria e Drejtësisë thekson faktin se parashtruesi i kërkesës ka kryer vepër penale edhe brenda territorit të Republikës së Kosovës, për çka është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Pejë përmes Aktgjykimit [P. nr. 884/21] të 4 majit 2023. Sipas Ministrisë së Drejtësisë, i njëjti ka paraqitur aplikacion për mbrojtje ndërkombëtare pas shpalljes së Aktgjykimit të lartpërmendur dhe pasi që 3 (tri) vendime për ekstradim ishin bërë të plotfuqishme. Në lidhje me këtë, Ministria e Drejtësisë shton se “[...] neni 6 i Ligjit 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, i cili në këtë rast është ligj special dhe që është në përputhje të plotë me Konventën e Këshillit të Evropës për Ekstradim dhe protokollat e saj shtesë, e përcakton se personave të cilëve u është dhënë azil politik në Republikën e Kosovës, nuk mund të ekstradohen kundër vullnetit të tyre, por që pas pranimit të kërkesës për ekstradim (Neni 6 par. 3) vendimi në bazë të cilit është dhënë azili politik, nuk ka efekt detyrues për procedurat e ekstradimit.”

## **Dispozitat Përkatëse Kushtetuese dhe Ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 27**

#### **[Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar]**

*“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruar.”*

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.  
[...]*”

## Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

### Neni 3 (Ndalimi i torturës)

*“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”*

### Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.*

**Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi Ekstradimin, dekretuar përmes Dekretit [DMN-013-2011] i 11 korrikut 2011.**

### Neni 1 Obligimi për ekstradim

*“1. Palët marrin përsipër dorëzimin tek njëra tjetra, sipas dispozitave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë peronat kundër të cilëve autoritet kompetente të Palës parashtruese të kërkesës kanë filluar procedurën gjyqësore për vepër penale ose që janë të kërkuar nga autoritet e cekura për ekzekutimin e një dënimi apo urdhër-arresti.*

*2. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, shprehja “urdhër-arrest” do të thotë cdo urdhër që përfshin privimin nga liria i cili është dhënë nga një gjykatë penale si dënim plotësues ose si zëvendësim i dënimit me burgim.”*

### Neni 22 Parimi i specialitetit

*“1. Personi i cili është ekstraduar nuk duhet të hetohet, dënohet apo arrestohet me qëllim të ekzekutimit të ndonjë dënimi apo urdhër-arresti për çfarëdo vepre tjetër penale, të kryer para dorëzimit të tij përveç asaj për të cilën ai është ekstraduar, gjithashtu atij nuk do t’i kufizohet liria personale, përveç në këto raste:*

- 1) Në rastin kur pala që e ka dorëzuar atë pajtohet. Kërkesa për pajtim duhet të paraqitet së bashku me dokumentet e përcaktuara në Nenin 14 dhe regjistri*

ligjor i çdo deklarate të bërë nga personi i ekstraduar lidhur me veprën në fjalë. Pajtimi duhet dhënë në rastet kur vepra penale për të cilën është kërkuar është subjekt i ekstradimit në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje.

- 2) Në rastin kur personi, edhe pse ka pasur mundësinë të largohet nga territori ku ai është dorëzuar, nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga momenti kur është liruar nga vepra penale, apo pasi është larguar, është kthyer përsëri në atë territor.

[...]"

## **Ligj Nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale**

### **Neni 6 (Qëllimi)**

*"1. Personi i kërkuar nga një shtet tjetër për qëllim të zhvillimit të procedurës penale ose për ekzekutimin e dënimit mund të ekstradohet nga Republikës së Kosovës në atë shtet, sipas kushteve të parapara me këtë ligj.*

*2. Personat e mëposhtëm nuk mund të ekstradohen kundër vullnetit të tyre:*

*2.1. Shtetasit e Republikës së Kosovës, përveç nëse parashihet ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit kërkues ose sipas së drejtës ndërkombëtare, siç parashihet në nenit 35 paragrafi 4. të Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Një marrëveshje ndërkombëtare mund të lidhet me qëllim të ekstradimit të një individi;*

*2.2. personat të cilëve iu është dhënë azil politik në Republikën e Kosovës;*

*2.3. shtetasit e huaj të cilët gëzojnë imunitetin e juridiksionit në Republikën e Kosovës, brenda kufijve të detyrimeve ndërkombëtare të marra nga Republika e Kosovës.*

*3. Statusi i shtetasit të Republikës së Kosovës ose të një refugjati politik përcaktohet nga koha e pranimit të kërkesës për ekstradim."*

### **Neni 11 (Skadimi i afatit të parashkrimit)**

*"Ekstradimi nuk lejohet në rastet kur është bërë parashkrimi i ndjekjes penale ose ekzekutimit të dënimit në pajtim me ligjin vendor ose ligjin e shtetit kërkues."*

### **Neni 17 (Klauzola jodiskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut)**

*1. Ekstradimi i një personi të kërkuar nuk lejohet nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkesa është bërë për qëllime të ndjekjes penale ose të ndëshkimit për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë, gjuhës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, anëtarësimit të tij apo saj në ndonjë grup shoqëror, apo nëse pozita e tij apo saj në shoqëri mund të paragjykohet për njërin nga këto arsye.*

*2. Ekstradimi nuk lejohet nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se personi i kërkuar mund t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimit.*

*3. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka arsye për të besuar se personi nuk do të pranojë garancitë minimale për një gjykim të drejtë në shtetin kërkues, siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*



4. Ekstradimi i kërkuar me qëllim të ekzekutimit të dënimit të shqiptuar me aktgjykim të dhënë në mungesë, lejohet vetëm nëse gjatë procedurës së zhvilluar kundër personit janë respektuar të drejtat minimale të mbrojtjes, të njohura për çdo person të akuzuar për kryerjen e një veprë penale.

Ekstradimi mund të lejohet nëse shteti kërkuës ofron garanci të mjaftueshme për të siguruar që personi i kërkuar ka të drejtën për rigjykim me qëllim që të sigurohen të drejtat minimale të mbrojtjes.

5. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka dyshime se personi do të gjykohet apo është gjykuar ose dënuar në shtetin kërkuës nga një gjykatë e jashtëzakonshme ose e përkohshme, përveç nëse shteti kërkuës jep garanci të mjaftueshme se gjykimi ose rigjykimi do të kryhet nga një gjykatë e rregullt në pajtim me ligjin.

6. Ekstradimi nuk lejohet për çfarëdo arsye tjetër të bazuar që do të paraqiste shkelje të së drejtës ndërkombëtare ose standardeve tjera të të drejtave të njeriut.

## **Ligj Nr. 08/L-026 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/l-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale**

### **Neni 17/A (Rregulli i specialitetit)**

“1. Ekstradimi nuk do të lejohet nëse nuk plotësohen kushtet si në vijim:

1.1. personi i kërkuar nuk do të dënohet në shtetin kërkuës pa pëlqimin e Republikës së Kosovës për çfarëdo arsye që ka lindur para ekstradimit të tij, me përjashtim të asaj veprë për të cilën është lejuar ekstradimi, e as nuk do të kufizohet në lirinë e tij personale ose të ndiqet penalisht përmes masave të cilat nuk do të mund të merreshin në mungesë të tij;

1.2. personi i kërkuar nuk do të riekstradohet, transferohet ose dëbohet në një shtet të tretë pa pëlqimin e Republikës së Kosovës; dhe

1.3. personi i kërkuar mund të largohet nga shteti kërkuës pas përfundimit me vendim të formës së prerë të procedurave për të cilat ishte lejuar ekstradimi.

2. Kërkesa që Shteti kërkuës duhet të respektojë rregullin e specialitetit nuk duhet të hiqet, përveç nëse:

2.1. është dhënë pëlqimi i Republikës së Kosovës për të ndjekur penalisht ose për të ekzekutuar një dënim ose sanksion tjetër për një veprë penale shtesë, siç përcaktohet në nenin 35A, ose për të riekstraduar, dorëzuar ose dëbuar në një shtet tjetër të huaj, siç përcaktohet në nenin 35B;

2.2. personi i kërkuar nuk e ka lëshuar shtetin kërkuës brenda një (1) muaji pas përfundimit të procedurave për të cilat është dhënë ekstradimi i tij edhe pse ai ka pasur mundësi dhe të drejtë ta bëjë këtë.

3. Kur personi i kërkuar, pas largimit nga shteti kërkuës, është rikthyer ose është dërguar atje nga një shtet i tretë, nuk do të cenohet e drejta e shtetit kërkuës për të marrë në pyetje personin e kërkuar për qëllime të përgatitjes së një kërkesë për miratim. 4. Lirimi i parakohshëm me kusht, pa urdhër që kufizon lirinë e lëvizjes së personit të kërkuar, do të ketë efekt të njëjtë sikurse përfundimi i procedurës me vendim të formës së prerë sipas paragrafit 1., nën-paragrafit 1.3. dhe paragrafit 2. të këtij neni.”

## **Kod Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës**

### **Neni 267**

**(Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge)**

“1. Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shites apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

2. Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shites ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

3. Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

4. Për qëllime të këtij kapitulli, shprehja “analog” nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe efektet e të cilave i riprodhon. 5. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.”

**Neni 313  
(Vjedhja)**

“1. Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

2. Nëse vlera e pasurisë së vjedhur është më pak se pesëdhjetë (50) euro, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.”

**Neni 336  
(Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes)**

“1. Kushdo që gjatë dhe në lidhje me ndonjë vepër tjetër penale, me përjashtim të neneve 114- 139, me dashje transferon, posedon ose shfrytëzon, pa autorizim ligjor, mjetin e identifikimit të personit tjetër, pajisjen e qasjes, ose informacionin e identifikimit të telekomunikimit, dënohet me burgim deri në dy (2) vjet.

2. Kushdo që gjatë dhe në lidhje me ndonjë vepër terroriste nga nenet 114-139, me dashje transferon, posedon ose shfrytëzon, pa autorizim ligjor, mjetin e identifikimit të personit tjetër, pajisjen e qasjes, informacionin e identifikimit të telekomunikimit, ose dokumentin e falsifikuar të identifikimit, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

3. Për qëllim të këtij neni, shprehja “mjet identifikimi” nënkupton çilindo emër ose numër që mund të përdoret, i vetëm apo në lidhje me ndonjë informacion tjetër, për të identifikuar një individ të caktuar, përfshirë emrin, datën e lindjes, lejen e vozitjes apo numrin e identifikimit, numrin e pasaportës, numrin e identifikimit të punëdhënësit ose tatimpaguesit, të dhënat unike biometrike, siç janë gjurmët e gishtave, mostra e zërit, imazhi i retinës apo irisit, ose ndonjë karakteristikë tjetër unike fizike; numrin unik të identifikimit elektronik, adresën, ose kursin.

4. Për qëllim të këtij neni, shprehja “pajisje e qasjes” nënkupton kartelën, pllakën, kodin, numrin e llogarisë, numrin serik elektronik, numrin e identifikimit të celularit, numrin personal të identifikimit; ose shërbime të tjera telekomunikuese, pajisje ose identifikues të instrumenteve; ose mjete të tjera të qasjes në llogari që mund të përdoren, vetëm ose në lidhje me një pajisje tjetër të qasjes, për të marrë para, mallra, shërbime ose ndonjë gjë tjetër me vlerë, ose që mund të përdoret për të inicuar transferimin e fondeve dhe përfshin “instrumentet e pagesës” siç përcaktohet në nenin 287 të këtij Kodi.

5. Për qëllim të këtij neni, shprehja “informacion i identifikimit të telekomunikimit” nënkupton numrin serik elektronik ose numrin apo sinjalin tjetër që identifikon një instrument ose llogari specifike të telekomunikimit, ose një komunikim specifik të transmetuar nga një instrument telekomunikimi.

6. Për qëllim të paragrafit 2 të këtij neni, shprehja “dokument i falsifikuar i identifikimit” nënkupton dokumentin që shërben ose që zakonisht përdoret për qëllim të identifikimit të individëve që nuk është lëshuar nga ose nën autoritetin e një subjekti qeveritar ose është lëshuar nën autoritetin e një njësie qeveritare, por më pas është ndryshuar për qëllime mashtrimi; dhe duket se është lëshuar nga ose nën autoritetin e Qeverisë së Kosovës ose ndonjë dege politike të Kosovës, qeverie të huaj, dege politike të një qeverie të huaj ose organizate ndërkombëtare qeveritare ose kuazi-qeveritare.

7. Tentativa për të kryer veprën nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme.”

#### **Neni 395 (Legalizimi i përmbajtjes së rreme)**

“1. Kushdo që vë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë në një çështje ligjore, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Kushdo që përdorë dokumentin, regjistrin apo librin e tillë edhe pse e di së është i rremë, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.”

#### **Neni 427 (Falsifikimi i dokumentit zyrtar)**

“1. Personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrit ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Personi zyrtar i cili shfrytëzon dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare të rreme si të vërtetë në veprimtarinë e tij afariste ose i cili asgjëson, fsheh, dëmton apo në ndonjë mënyrë tjetër e bën të papërdorshëm dokumentin zyrtar, regjistrin ose shkresën zyrtare, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.”

### **Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës**

#### **Neni 107 (Fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale)**

*“1. Afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Nëse ndonjë pasojë që përbën element të veprës penale shfaqet më vonë, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga ajo kohë.*

*2. Në rast se vepra penale është kryer kundër personit nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjet, afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga dita kur viktimat të ketë mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.*

*3. Afati i parashkrimit nuk rrjedh për kohën gjatë të cilës ndjekja nuk mund të fillohet apo të vazhdohet sipas ligjit, përfshirë, por pa u kufizuar në rrethanat e mëposhtme:*

*3.1. kur kryesi është jashtë Republikës së Kosovës dhe kjo shkakton vonesa në procedurë; 3.2. kur kryesi kërkohet me urdhër arrest;*

*3.3. kur Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, përpiket të sigurojë dëshmi jashtë Republikës së Kosovës; ose 3.4. gjatë kohës sa zgjatë procedura për pranimin e fajësisë.*

*[...]”*

### **Neni 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve)**

*“1. Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet pasi të kenë kaluar:*

*1.1. tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim të përjetshëm;*

*1.2. njëzetë (20) vjet nga dënimi me mbi dhjetë (10) vjet burgim;*

*1.3. dhjetë (10) vjet nga dënimi me mbi pesë (5) vjet burgim;*

*1.4. pesë (5) vjet nga dënimi me mbi tri (3) vjet burgim;*

*1.5. tri (3) vjet nga dënimi me mbi një (1) vit burgim; dhe*

*1.6. dy (2) vjet nga dënimi me burgim deri në një (1) vit apo dënimi me gjobë.*

*2. Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve ndërpritet kur personi i dënuar nuk paraqitet ose nuk dorëzohet për mbajtjen e dënimit me burgim.”*

### **Neni 110 (Fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit)**

*“1. Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, e në rast se dënimi alternativ është revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin merr formën e prerë.*

*2. Afati i parashkrimit nuk rrjedh gjatë kohës kur sipas ligjit ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillohet.*

*3. Nëse dënimi zbutet me falje apo me vendim të gjykatës sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, koha e fillimit të parashkrimit caktohet sipas dënimit të ri, derisa llogaritja e parashkrimit bëhet sipas dënimit fillestar.*

*4. Afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit.*

*5. Pas çdo ndërprerjeje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit.*

*6. Ekzekutimi i dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.*

*7. Dispozitat nga paragrafët 2. deri 5. të këtij neni po ashtu zbatohen për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.”*

## **Ligj Nr. 06/L-026 për Azil**

### **Neni 5**

## **(Ndalimi i dëbimit ose i kthimit (Non -refoulement))**

*“1. Republika e Kosovës nuk duhet ta dëbojë ose ta kthejë aplikuesin, refugjatin, personin nën mbrojtje plotësuese apo personin nën mbrojtje të përkohshme në asnjë mënyrë në kufijtë e territoreve, ku do t’i kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.*

*2. Përfitimet nga paragrafi 1. i këtij neni nuk do të mund të kërkohen nga një aplikues refugjat, person me mbrojtje plotësuese apo person nën mbrojtje të përkohshme, për të cilin ka arsye të forta të mendohet se ai paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës apo i cili duke qenë i dënuar me vendim të formës së prerë për një krim veçanërisht të rëndë, paraqet rrezik për sigurinë e Republikës së Kosovës.*

*3. Në rastet nga paragrafi 2. i këtij neni, leja e qëndrimit do të revokohet për një person, por nuk do të kthehet, të dëbohet ose do të ekstradohet për shkaqet që rrjedhin nga e drejta për jetë dhe ndalimi i torturës, trajtimi mizor, çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimi.”*

### **Neni 61 (Vendimi i shkallës së parë)**

*“1. DSHAM-i merr vendim përmes të cilit:*

*1.1. e njeh statusin e refugjatit;*

*1.2. refuzon statusin e refugjatit dhe njeh statusin e mbrojtjes plotësuese;*

*1.3. refuzon aplikacionin për mbrojtje ndërkombëtare;*

*1.4. ndërprejnë procedurën për përcaktim të statusit të mbrojtjes ndërkombëtare.*

*2. DSHAM-i do të marrë vendim në formë të shkruar dhe në rastet kur aplikacioni për mbrojtje ndërkombëtare refuzohet, arsyet faktike dhe ligjore duhet të jenë cekur në vendimin përkatës, si dhe informacionet lidhur me mundësinë e parashtrimit të ankesës.”*

### **Neni 63 (Aplikacioni i pabazuar)**

*“1. DSHAM-i do të refuzojë aplikacionin për mbrojtje ndërkombëtare i cili konsiderohet i pabazuar në procedurë të përshpejtuar në pajtim me garancitë procedurale të përcaktuara në këtë ligj në rastet kur:*

*1.1. aplikuesi, në momentin e parashtrimit të aplikacionit të tij apo saj dhe fakteve përkatëse, ka ngritur vetëm çështje që nuk janë relevante për shqyrtimin nëse ai ose ajo kualifikohet si përfitues i mbrojtjes ndërkombëtare në pajtim me këtë ligj;*

*1.2. aplikuesi vjen nga një shtet i sigurt i origjinës, brenda kuptimit të këtij ligji;*

*1.3. aplikuesi ka mashtruar organin kompetent duke paraqitur informata apo dokumente të rrejshme, ose duke fshehur informata apo dokumente relevante që vërtetojnë identitetin apo shtetësinë e tij ose saj, në rast se kjo do të kishte ndikim negativ në vendim; ose*

*1.4. ka gjasa që, me qëllime të këqija, aplikuesi të ketë shkatërruar apo zhdukur dokumentet e identitetit apo udhëtimet të cilat do të ndihmonin në përcaktimin e identitetit apo shtetësisë së tij apo saj; ose*

*1.5. aplikuesi ka bërë deklaratatë jokonsistente dhe kundërthënëse, qartas të rrejshme apo dukshëm të paqëndrueshme, të cilat bien ndesh me informatat e vërtetuara që vijnë për shtetin e origjinës, duke bërë kështu pretendime qartë jo të bindshme në lidhje me atë nëse ai ose ajo kualifikohet si përfitues i mbrojtjes*

ndërkombëtare, në kuptim të këtij ligji; 1.6. aplikuesi ka paraqitur një aplikim tjetër për mbrojtje ndërkombëtare që nuk është e pranueshme sipas nenit 64 të këtij ligji; ose

1.7. aplikuesi është duke paraqitur aplikacionin vetëm për të vonuar apo penguar një vendim të mëhershëm që do të rezultonte me largimin e tij apo saj; ose

1.8. aplikuesi ka hyrë në territorin e Republikës së Kosovës në mënyrë të paligjshme ose e ka shtyrë qëndrimin në Republikën e Kosovës në mënyrë të paligjshme dhe pa arsye të qëndrueshme, ose nuk është paraqitur para organit kompetent ose nuk ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare sa më shpejtë që ka qenë e mundur, marrë parasysh rrethanat e hyrjes së tij apo saj; ose

1.9. aplikuesi refuzon veprimin në pajtim me obligimet për të dhënë shenjat e gishtërinjve sipas nenit 34 të këtij ligji;

1.10. aplikuesi mundet, për arsye serioze, të konsiderohet si rrezik për sigurinë publike ose rendin publik në Republikën e Kosovës, ose aplikuesi është dëbuar me dhunë për arsye serioze për sigurinë publike apo rendin publik, në bazë të legjislacionit kombëtar.

2. Organi kompetent do ta informojë aplikuesin me kohë për zbatimin e konceptit të vendit të sigurt të origjinës, në mënyrë që t'i mundësohet atij/asaj për të kundërshtuar zbatimin e konceptit të vendit të sigurt të origjinës në kontekst të natyrës dhe rrethanave të tij personale në kuptimin e kualifikimeve të tij/saj për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare sipas këtij ligji.

3. Dispozitat e nenit 60 të këtij ligji nuk do të zbatohen për aplikuesit në pozitë të cënueshme të cilët kanë nevojë për garanci të veçanta procedurale, sidomos viktimat e torturës, përdhunimit ose një formë tjetër e dhunës serioze psikologjike, fizike ose seksuale, në qoftë se garancitë e veçanta/përkrahja e duhur nuk mund të sigurohet.

4. Aplikacionet e fëmijëve të pashoqëruar mund të shqyrtohen dhe vendimi të bazohet në arsyet e përcaktura në nën-paragrafët 1.2., 1.6. dhe 1.10. të këtij neni.”

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

77. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

78. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

79. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individidi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

80. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 184/2024] e 21 marsit 2024 të Gjykatës Supreme, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
81. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara në rregullin 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Në këtë drejtim, paragrafi 2 i rregullit 34 specifikon:

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

82. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në meritat e saj dhe pas vlerësimit të tyre, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të

shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Aktgjykim i 28 janarit 2011, paragrafi 55; [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; dhe [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53).

83. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
84. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që në rastin e parashtruesit të kërkesës ishin zhvilluar disa procedura:
- (1) Procedura penale në Turqi për disa vepra penale, përfshirë (i) shpalljen fajtor të parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk, për të cilën i ishte shqiptuar dënim me 2 (dy) vite burgim, i cili ishte bërë i formës së prerë më 4 maj 2018; (iii) procedura penale me shenjë [2021/161 Esas] pranë Gjykatës Themelore për Krimet e Rënda nr.3-Izmir si dhe procedura penale me shenjë [2020/500 Esas] pranë Gjykatës Themelore për Krimet e Rënda nr. 2-Stamboll, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” nga neni 188/3 dhe “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” në bashkëkryerje, nga nenet 188/3 dhe 188/5 të Kodit Penal Turk; dhe (iii) shpalljen fajtor nga autoritetet gjyqësore turke për kryerjen e disa veprave penale, përkatësisht nga: Gjykata Themelore e Krimeve të Rënda në Stamboll Nr. 5 për kryerjen e veprës penale “*Vrasje e të afërmit të ngushtë*”; Gjykata Themelore Penale në Konya Nr. 8 për kryerjen e veprës penale “*Vjedhje duke shpërdorur besimin*” dhe Gjykata Themelore Penale në Stamboll Nr. 42 për kryerjen e veprës penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*”; përderisa (iv) i njëjti kërkohet nga autoritetet e Turqisë për veprat penale “*Falsifikim i dokumenteve zyrtare*” nga neni 204/1 dhe “*Vjedhje e sendit të vendosur në ruajtje*” nga neni 142/1-B të Kodit Penal Turk.
  - (2) Procedura përkitazi me 5 (pesë) kërkesa për ekstradim nga Ministria e Drejtësisë e Turqisë, lidhur me të cilat ishin zhvilluar procedurat si në vijim:
    - (i) Procedura e parë që ndërlihet me 2 (dy) kërkesat e para për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me veprat penale “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” dhe “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” në bashkëkryerje, sipas Kodit Penal Turk, me ç’ rast rezultoi në lejimin e ekstradimit të tij përmes Aktvendimit [PK. nr. 117/21] të 11 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore dhe dhënien e pëlqimit për ekstradim përmes Vendimit të Ministrisë së Drejtësisë.



- (ii) Procedura e dytë që ndërlidhet me kërkesën e tretë për ekstradim të parashtruesit të kërkesës lidhur me veprat penale “*Vrasje e të afërmit të ngushtë*”, “*Vjedhje duke shpërdorur besimin*” dhe “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*”, sipas Kodit Penal Turk, që rezultoi në lejimin e ekstradimit të tij përmes Aktvendimit [PK. nr. 124/2021] të 27 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore, të vërtetuar nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. Nr. 500/2024] të 3 prillit 2024 si dhe në dhënien e pëlqimit për ekstradim përmes Vendimit të Ministrisë së Drejtësisë.
- (iii) Procedura e tretë që ndërlidhet me kërkesën e katërt për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës me qëllim të vuajtjes së dënimit me burgim për veprën penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas Kodit Penal Turk, që rezultoi në lejimin e ekstradimit të tij përmes Aktvendimit [PK.nr.116/2022], vendim të cilin e vërtetoi më pas Gjykata e Apelit dhe, në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 184/2024] të 3 majit 2024.
- (iv) Procedura e katërt e cila ndërlidhet me kërkesën e pestë të autoriteteve turke për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës lidhur me veprat penale “*Falsifikim i dokumenteve zyrtare*” dhe “*Vjedhje e sendit të vendosur në ruajtje*” sipas Kodit Penal Turk që rezultoi në lejimin e ekstradimit të tij përmes Aktvendimit [PK. nr. 2/2024] të 4 marsit 2024 të Gjykatës Themelore, vendim ky i cili u vërtetua përmes Aktvendimit [PN. nr.500/2024] të Gjykatës së Apelit dhe, në dhënien e pëlqimit për ekstradimin e tij përmes Vendimit [Nr. 99/2024] të 2 majit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë.
- (3) Procedura përkitazi me dhënien e pëlqimit të Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës, përmes së cilës ishte lejuar ekstradimi përfshirë ekstradimin e parashtruesit të kërkesës me qëllim të vuajtjes së dënimit me burgim për veprën penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas Kodit Penal Turk, që rezultoi në lejimin e ekstradimit të tij përmes Aktvendimit [PK.nr.116/2022], vendim të cilin e vërtetoi më pas Gjykata e Apelit dhe, në fund, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Pml. nr. 184/2024] të 3 majit 2024. Kjo procedurë kishte kulmuar në Aktgjykimit [AA. nr. 574/2024] e Gjykatës së Apelit, që refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [A. nr. 1980/2024] e 24 majit 2024 të Gjykatës Themelore, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.
- (4) Procedura përkitazi me kryerjen e veprës penale “*Legalizim i përmbajtjes së rreme*” sipas paragrafit 2 lidhur me paragrafin 1 të nenit 395 të KPRK-së, të kryer në Kosovë për të cilën, më 4 maj 2023, Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktgjykimit [P.nr. 884/21] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale në fjalë duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dënim ky i cili me pëlqimin e parashtruesit të kërkesës mund t'i zëvendësohej në dënim me gjobë në shumën prej 2000 (dy mijë) euro.
- (5) Procedura e azilit e cila ishte shqyrtuar nga organet administrative dhe aktualisht është në shqyrtim në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila është duke trajtuar padinë kundër Vendimit [KKR. Nr. 08/2024] të 3 prillit 2024 të Komisionit Kombëtar për Refugjatë.

85. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston para Gjykatës procedurën e tretë që ndërlidhet me veprën penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk, përkatësisht konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 184/2024] e 3 majit 2024 të Gjykatës Supreme. Andaj, Gjykata thekson se procedurat e tjera të lartcekura dhe vendimet përkitazi me to, nuk janë objekt shqyrtimi para Gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata do të kufizohet vetëm në vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara që ndërlidhen me procedurën e tretë të ekstradimit e që ndërlidhet me kërkesën e katërt të Turqisë, për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës me qëllim të vuajtjes së dënimit me burgim për veprën penale “*Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës*” sipas Kodit Penal Turk, që rezultoi në lejimin e ekstradimit të tij përmes Aktvendimit [PK.nr.116/2022] të Gjykatës Themelore, vendim të cilin e vërtetoi më pas Gjykata e Apelit dhe, në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 184/2024] të 3 majit 2024.
86. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar [Pml. nr. 184/2024] të Gjykatës Supreme, atij i janë shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit dhe mosarsyetimit të vendimit gjyqësor, duke theksuar se (i) ekzekutimi i dënimit të shqiptuar ndaj tij ka arritur parashkrimin, përfshirë parashikimin relativ sipas KPRK-së së vitit 2012, më 8 prill 2022 dhe se parashkrimi i ekzekutimit të dënimit në çdo rast ndalohej kur të ketë kaluar dyfishi i afatit të parashkrimit; (ii) gjykatat e rregullta nuk kanë arsyetuar vendimet e tyre sa i përket parashkrimit duke rezultuar në konkluzione arbitrare dhe qartazi të paarsyeshme; (iii) ekstradimi i tij në Turqi paraqet shkelje të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 17 (Klauzola jodiskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut) të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale që ndalojnë ekstradimin kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se personi i kërkuar mund t’i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimit apo kur mund të ketë shkelje të së drejtës ndërkombëtare dhe standardevë tjera të të drejtave të njeriut; (iv) ekstradimi në fjalë shkel nenin 5 (Ndalimi i dëbimit ose i kthimit (Non -refoulement) të Ligjit për Azil, me arsyetimin se i njëjti ndalon dëbimin apo kthimin e aplikuesit në kufijtë e territorit ku do t’i kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës ka paraqitur pretendime lidhur me (v) caktimin e masës së paraburgimit të shqiptuar kundër tij si dhe përkitazi me kërkesën e tij për vendosjen e masës së përkohshme kundër Vendimit [Nr. 99/2024] të Ministrisë së Drejtësisë.
87. Në anën tjetër, Ministria e Drejtësisë pretendon, mes tjerash, se (i) veprat penale për të cilat kërkohet parashtruesi i kërkesës nga autoritetet e Turqisë, si për vuajtje të dënimit ashtu edhe për ndjekje penale, nuk janë vepra politike dhe as nuk ndërlidhen me to si dhe i njëjti kërkohet për veprat penale të lartcekura dhe jo për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë dhe gjuhës; (ii) Interpol refuzon shpalljen në kërkim ndërkombëtar të personave të kërkuar nga Turqia që janë pjesëtarë të lëvizjes “*Feto*”, përderisa në rastin e parashtruesit të kërkesës i njëjti është në listën e të kërkuarve në Interpol; dhe se (iii) parashtruesi i kërkesës ka kryer vepër penale edhe brenda territorit të Republikës së Kosovës, për çka është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Pejë përmes Aktgjykimit [P. nr. 884/21] të 4 majit 2023.
88. Më konkretisht, përmes përgjigjes së lartcekur, Ministria e Drejtësisë theksoi se “*Përveç tjerash, Kushtetuta e Interpolit i përcakton disa kushte që kanë të bëjnë me drejtat e njeriut dhe nëse ka dyshime se personi që shpallet në kërkim ndërkombëtar nga Interpoli*

*mund të jetë subjekt i shkëljes së të drejtave të njeriut ose kërkesa për të futur një person në listën e personave të kërkuar nga Interpoli është motivuar, për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë, gjuhës, etj, Interpoli refuzon shpalljen e atij personi në kërkim ndërkombëtar. Prandaj, pikërisht për këtë arsye ka refuzuar që t'i fus në sistem ose t'i shpall në kërkim ndërkombëtar personat e kërkuar nga Turqia si pjesëtar të organizatës së ashtuquajtur "Feto".*

89. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, së pari, do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përmes të cilave garantohet e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, është i zbatueshëm në rrethanat e rastit konkret. Në vlerësimin e saj, Gjykata do të aplikojë parimet e përgjithshme të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vet Gjykatës, të aplikueshme në procedura të ekstradimit.

**(i) Përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së**

90. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, në bazë të së cilës sipas nenit 53 të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, përcakton që vendimet lidhur me ekstradimin nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile të parashtruesve apo akuzën penale ndaj tij/saj brenda kuptimit të nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së (rastet e GJEDNJ-së [Penafiel Salgado kundër Spanjës](#), nr. 65964/01, Vendim i 16 prillit 2002; [Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 14038/88, Aktgjykim i 7 korrikut 1989; [Ahorugeze kundër Suedisë](#), nr. 37075/09, Aktgjykim i 4 qershorit 2012; dhe rastin e Gjykatës [KI10/23](#), parashtrues *Besim Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 shkurtit 2023, paragrafi 72).
91. Sipas GJEDNJ-së dhe praktikës së Gjykatës, çështja e ekstradimit përjashtimisht mund të ngrihet sipas nenit 6 të KEDNJ-së, nga një vendim për ekstradim në rrethanat kur individit do të rrezikonte të pësonte "*mohim flagrant*" të garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së, në vendin kërkues. (shih, rastin e GJEDNJ-së [Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 113; dhe rastin e Gjykatës [KI10/23](#), cituar më lart, paragrafi 73).
92. Megjithatë, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka theksuar se kur një parashtrues përballet me ekstradimin në një shtet tjetër, i cili është palë kontraktuese në KEDNJ, supozimi është se personi do të ketë një gjykim të drejtë, marrë në veçanti për bazë ekzistencën e mjeteve juridike kundër çdo padrejtësie të mundshme në atë vend, duke përfshirë edhe parashtrimin eventual të një kërkesë në GJEDNJ (shih, rastin e GJEDNJ-së [Stapleton kundër Irlandës](#), nr. 56588/07, Vendim i 4 majit 2010, paragrafi 26; dhe shih rastin e Gjykatës [KI10/23](#), cituar më lart, paragrafi 76).
93. Në zberthim të këtij testi, GJEDNJ konsideron se duhet të zbatohet i njëjti standard dhe barra e provës si në shqyrtimin e ekstradimeve dhe dëbimeve sipas nenit 1 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, i takon parashtruesit të paraqesë prova të mjaftueshme për të vërtetuar se ka arsye thelbësore për të besuar se, nëse largohet nga një shtet kontraktues, ai do të ekspozohet ndaj një rreziku real për t'iu nënshtruar një "*mohimi flagrant të drejtësisë*" (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Saadi kundër Italisë](#), nr. 37201/06, Aktgjykim i 28 shkurtit 2008).

94. Andaj, në rastin konkret, Gjykata së pari vëren se Republika e Turqisë është palë kontraktuese e KEDNJ-së, dhe si e tillë, ka marrë përsipër të respektojë obligimet e KEDNJ-së dhe t'i sigurojë secilit person brenda juridiksionit të saj të drejtat dhe detyrimet e garantuara përmes KEDNJ-së, përfshirë të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 të saj.
95. Së dyti, parashtruesi i kërkesës nuk pretendon se me rastin e ekstradimit ai do t'i nënshtrohet cenimit të parimeve të gjyqimit të drejtë të garantuara me nenin 6 të KEDNJ-së, por thekson se ai do të përballlet me trajtimin që është në kundërshtim me nenin 3 (Ndalimi i torturës) të KEDNJ-së në shtetin pranues.
96. Thënë këtë, Gjykata vëren se bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, pretendimet e tilla vlerësohen dhe shqyrtohen në kuadër të nenit 3 (Ndalimi i torturës) të KEDNJ-së dhe nenit 27 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata pretendimet e parashtruesit të kërkesës të ngritura në kërkesën e tij do t'i shqyrtojë dhe vlerësojë bazuar në nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimin Mëzor, Çnjerëzor dhe Poshtëruar] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 3 të KEDNJ-së.

***(ii) Përkitazi me parimet që ndërlidhen me ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor në kontekst të ekstradimit dhe kërkesave për azil dhe zbatimin e tyre në rastin konkret***

97. Gjykata fillimisht vë në dukje se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ndalimi i torturës dhe trajtimin çnjerëzor i përcaktuar në nenin 3 të KEDNJ-së, është një ndër vlerat themelore të një shoqërie demokratike dhe gjithashtu vlerë e civilizimit e ndërlidhur ngushtësisht me respektimin e dinjitetit njerëzor, pjesë thelbësore e KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së, [Khlaifia dhe të tjerë kundër Italisë](#), nr. [16483/12](#), Aktgjykim i 15 dhjetorit 2016, paragrafi 158; dhe [Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë](#), nr. [47287/15](#), Aktgjykim i 21 nëntorit 2019, paragrafi 124).
98. Në këtë kontekst, siç ka theksuar GJEDNJ, shtetet kanë të drejtë, si çështje e mirë-përcaktuar e të drejtës ndërkombëtare dhe subjekt i obligimeve të tyre kontraktuese përfshirë KEDNJ-në, që të kontrollojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Lidhur me këtë, GEDNJ ka sqaruar se, e drejta për azil, nuk është e përcaktuar as në KEDNJ dhe as në protokollet e saj (shih, rastin e GJEDNJ-së [Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë](#), cituar më lart, paragrafi 125).
99. Megjithatë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, dëbimi, ekstradimi apo çdo masë tjetër për të larguar të huajt mund të ngre çështje brenda nenit 3 të KEDNJ-së, dhe si rrjedhojë mund të ngrejë përgjegjësinë e shteteve kontraktuese të KEDNJ-së, kur janë paraqitur baza të mjaftueshme përmbajtjesore për të besuar se personi në fjalë, nëse do të largohej, do të përballlej me rrezikun që ai të përballlet me trajtimin që është në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së, në shtetin pranues. Në këto rrethana, neni 3 i KEDNJ-së nënkupton obligimin që të mos dërgohet personi në shtetin tjetër (shih, rastet e GJEDNJ-së [Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafët 90-91 dhe [Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë](#), cituar më lart, paragrafi 126).
100. Më tej, GJEDNJ sqaron se vlerësimi nëse ekzistojnë arsye përmbajtjesore për të besuar se parashtruesi përballlet me rrezikun që t'i nënshtrohet trajtimin në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së, duhet të jetë rigoroz dhe detyrimisht përfshin vlerësimin nga autoritetet

vendore dhe më vonë GJEDNJ-së, në lidhje me kushtet në shtetin pranues në raport me standardin e nenit 3 të KEDNJ-së. Këto standarde nënkuptojnë që keqtrajtimi që parashtruesi pretendon se do të përballet nëse kthehet, duhet të arrijnë një nivel të seriozitetit për të aplikuar fushëveprimin e nenit 3, dhe se vlerësimi i tillë bëhet bazuar në të gjitha rrethanat e rastit (shih, rastin e GJEDNJ-së [Ilias dhe Ahmed kundër Hungarisë](#), cituar më lart, paragrafi 127). Nëse ekzistenca e rrezikut të tillë vërtetohet, largimi i parashtruesit do të përbente shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, pavarësisht nëse rreziku vjen si rezultat i gjendjes së përgjithshme të dhunës, karakteristikave personale të parashtruesit apo kombinimit të të dyja këtyre të fundit (shih, rastin e GJEDNJ-së [Khasanov dhe Rakhmanov kundër Ruisë](#), nr. 28492/15 dhe 49975/15, Aktgjykim i 29 prillit 2022, paragrafi 95).

101. Në kontekst të kësaj, GJEDNJ ka theksuar se kjo e fundit në raste të largimit të azilkërkuësit, nuk vlerëson vet aplikacionin për azil apo nuk verifikon se si shtetet i zbatojnë obligimet e tyre bazuar në Konventën për Refugjatë. Çështja që ngrihet është nëse ekzistojnë garancitë efektive për të mbrojtur parashtruesit nga kthimi arbitrar, direkt apo indirekt, në vendin nga ku ai është larguar. Bazuar në nenin 1 të KEDNJ-së, detyra primare për zbatimin e te drejtave të garantuara i takon autoriteteve shtetërore, marrë për bazë edhe parimin e subsidiaritetit (shih rastin e GJEDNJ-së [F.G. kundër Suedisë](#), nr. 43611/11, Aktgjykim i 23 marsit 2016, paragrafi 117).
102. Po ashtu, GJEDNJ ka vlerësuar se në rastet kur parashtruesi i kërkesës pretendon që ai ose ajo i takon një grupi i cili sistematikisht i ekspozohet praktikës së keqtrajtimit, mbrojtja e nenit 3 të KEDNJ-së vjen në shprehje kur parashtruesi paraqet prova, që ka arsye serioze për të besuar në ekzistimin e praktikave të tilla dhe se ai/ajo është anëtar i një grupi të tillë (shih rastin e GJEDNJ-së [F.G. kundër Suedisë](#), cituar më lart, paragrafi 120). Për GJEDNJ-në duhet të jetë e pranueshme, megjithatë, që vlerësimi i bërë nga autoritetet e shtetit anëtar është adekuat dhe mbështetet mjaftueshëm nga materiali vendor si dhe materialet nga burime të besuara dhe objektive si ato të shteteve tjera kontraktuese apo shteteve të treta, agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe të organizatave jo-qeveritare me reputacion (shih rastin e GJEDNJ [Shenturk dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit](#), nr. 41326/17, Aktgjykim i 10 qershorit 2022, paragrafët 112)
103. Prandaj, sipas GEDNJ-së, shtetet anëtare janë më mirë të pozicionuara për të vlerësuar jo vetëm faktet por, veçanërisht, kredibilitetin e dëshmitarit pasi janë ato që kanë pasur mundësinë të shohin, dëgjojnë dhe vlerësojnë sjelljen e personit në fjalë (shih, rastin e GJEDNJ-së [F.G. kundër Suedisë](#), cituar më lart, paragrafi 118).
104. Ndërsa, në anën tjetër, dhe më konkretisht sa i përket procedurës së azilit, në rastet kur autoritetet shtetërore kanë dështuar për të vlerësuar çdo pretendim të rrezikut në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së para se të largojnë personin që ka paraqitur kërkesën e azilit, në vendin e tyre të origjinës, Gjykata ka konstatuar dështim të shtetit që t'i përmbahet obligimeve procedurale të nenit 3 të KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ [Shenturk dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit](#), cituar më lart, paragrafët 116). Më konkretisht, në rastin [Shenturk dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit](#), GJEDNJ kishte theksuar se autoritetet vendase nuk kishin vlerësuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës për keqtrajtim në rast të kthimit në shtetin e tyre dhe se largimi i tyre nga Azerbajxhani për në Turqi, ishte bërë duke iu shmangur procedurave formale të ekstradimit e që në fakt, sipas GJEDNJ-së, ishte një “*ekstradim i maskuar*” ku ishin anashkaluar garancitë e parashikuara me të drejtën vendore dhe ndërkombëtare (shih,

rastin e GJEDNJ-së Shenturk dhe të tjerët kundër Azerbajxhanit, cituar më lart, paragrafi 114).

105. Gjykata po ashtu vëren se parimet e lartcekura janë të reflektuara edhe në Ligjin për Bashkëpunim Ndërkombëtar, i cili në nenin 17 (Klauzola jodiskriminuese dhe standardet e të drejtave të njeriut) të tij përcakton:

*“1. Ekstradimi i një personi të kërkuar nuk lejohet nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkesa është bërë për qëllime të ndjekjes penale ose të ndëshkimit për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë, gjuhës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, anëtarësisë së tij apo saj në ndonjë grup shoqëror, apo nëse pozita e tij apo saj në shoqëri mund të paragjykohet për njërin nga këto arsye.*

*2. Ekstradimi nuk lejohet nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme se personi i kërkuar mund t'i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimit.*

*3. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka arsye për të besuar se personi nuk do të pranojë garancitë minimale për një gjykim të drejtë në shtetin kërkuar, siç parashihet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.*

*4. Ekstradimi i kërkuar me qëllim të ekzekutimit të dënimit të shqiptuar me aktgjykim të dhënë në mungesë, lejohet vetëm nëse gjatë procedurës së zhvilluar kundër personit janë respektuar të drejtat minimale të mbrojtjes, të njohura për çdo person të akuzuar për kryerjen e një veprë penale.*

*Ekstradimi mund të lejohet nëse shteti kërkuar ofron garanci të mjaftueshme për të siguruar që personi i kërkuar ka të drejtën për rigjykim me qëllim që të sigurohen të drejtat minimale të mbrojtjes.*

*5. Ekstradimi nuk lejohet nëse ka dyshime se personi do të gjykohet apo është gjykuar ose dënuar në shtetin kërkuar nga një gjykatë e jashtëzakonshme ose e përkohshme, përveç nëse shteti kërkuar jep garanci të mjaftueshme se gjykimi ose rigjykimi do të kryhet nga një gjykatë e rregullt në pajtim me ligjin.*

*6. Ekstradimi nuk lejohet për çfarëdo arsye tjetër të bazuar që do të paraqiste shkelje të së drejtës ndërkombëtare ose standardeve tjera të të drejtave të njeriut.”*

106. Në zbatimin e këtyre standardeve, Gjykata vëren se Gjykata Themelore ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për ekstradimin e tij sipas Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale dhe Marrëveshjes Dypalëshe mbi Ekstradimin, përfshirë vlerësimin se në rastin e tij nuk ka rrezik që i njëjti t'i nënshtrohet torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues. Kjo duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës nuk është person i kërkuar për vepra politike, vepra penale ushtarake apo vepra penale për të cilat parashihet dënimi me vdekje ose burgim të përjetshëm. Këto gjetje të Gjykatës Themelore janë vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme.

107. Gjykata gjithashtu rikujton përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë që thekson se “Kushtetuta e Interpolit i përcakton disa kushte që kanë të bëjnë me drejtat e njeriut dhe nëse ka dyshime se personi që shpallet në kërkim ndërkombëtar nga Interpoli mund të jetë subjekt i shkeljes së të drejtave të njeriut ose kërkesa për të futur një person në listën e personave të kërkuar nga Interpoli është motivuar, për shkak të racës, fesë, gjinisë, shtetësisë, bindjes politike, etnisë, gjuhës, etj, Interpoli refuzon shpalljen e atij personi në kërkim ndërkombëtar. Prandaj, pikërisht për këtë arsye ka refuzuar që t'i fus në sistem ose t'i shpall në kërkim ndërkombëtar personat e kërkuar nga Turqia si pjesëtar të organizatës së ashtuquajtur “Feto” dhe se (ii) parashtruesi i kërkesës ka kryer vepër penale edhe brenda

territorit të Republikës së Kosovës, për çka është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Pejë përmes Aktgjykimit [P. nr. 884/21] të 4 majit 2023.

108. Prandaj, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij se ai i takon grupit të rrezikuar dhe se me rastin e ekstradimit të tij në Turqi, ai do të përballet me shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së dhe nenit 27 të Kushtetutës.
109. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se, përmes vendimeve të tyre, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk e kanë arsyetuar parashkrimin e ekzekutimit të dënimit në kuptim të nenit 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve) të KPRK-së së vitit 2012, por është mjaftuar me informatat e pranuar nga autoritetet turke se parashkrimi për ekzekutimin e dënimit sipas ligjit në Turqi për veprën penale në fjalë është 10 (dhjetë) vite.
110. Po ashtu, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se konstatimi i Gjykatës Themelore përmes Aktvendimit [PK. nr. 116/2022] të 29 dhjetorit 2023, se kërkesa e tij për azil është refuzuar pasi që i njëjti nuk mund të gëzojë të drejtën e azilit është në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut pasi që sipas tij për të drejtën e azilit vendosë Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim dhe jo gjykata që ka në shqyrtim çështjen penale.
111. Gjykata në ndërlidhje me këtë vëren se në rastin konkret ekziston Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë mbi Ekstradimin, e dekretuar më 11 korrik 2011, përmes Dekretit [DMN-013-2011] ku në nenin 1 [Obligimi për Ekstradim] të kësaj të fundit përcaktohet se *“palët marrin përsipër dorëzimin tek njëra tjetra, sipas dispozitave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë peronat kundër të cilëve autoritet kompetente të Palës parashtruese të kërkesës kanë filluar procedurën gjyqësore për veprë penale ose që janë të kërkuar nga autoritet e cekura për ekzekutimin e një dënimi apo urdhër-arresti”*.
112. Në lidhje me këtë që u tha më lart, Gjykata së pari i referohet nenit 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] të Kushtetutës, i cili parasheh që *“Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji”*.
113. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [PK. nr. 116/2022] të 29 dhjetorit 2023, kur kishte konstatuar se ishin plotësuar kushtet ligjore për lejimin e ekstradimit të parashtruesit të kërkesës për në Turqi, kishte adresuar çështjen e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit të shqiptuar kundër tij nga Gjykata Themelore Penale Nr. 5 e Karsiyaka në Izmir, për kryerjen e veprës penale *“Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës”*.
114. Më konkretisht, lidhur me çështjen e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, Gjykata vëren se Gjykata Themelore konstatoi se nga informatat e pranuar nga autoritetet e Turqisë vërtetohej fakti se urdhër-arresti ndaj parashtruesit të kërkesës ishte lëshuar me 10 shtator 2018, se nuk kishte pasur ndërprerje të tij dhe se parashkrimi lidhur me veprën penale për të cilën ishte dënuar arrihet më 4 maj 2028. Për më tepër, Gjykata rikujton se në arsyetimin e aktvendimit të lartcekur, Gjykata Themelore, duke u mbështetur në pikën 1.5 të paragrafit 1 të nenit 108 (Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit) të KPRK-së së vitit 2012, konstatoi se

- nuk ka parashkrim të ekzekutimit të dënimit. Në këtë aspekt, Gjykata Themelore arsyetoi se sipas kësaj dispozite “[...] parashihet afati i parashkrimit prej 3 vite dhe dyfishi i këtij afati është 6 vite.”
115. Më tej, në lidhje me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, Gjykata thekson se Gjykata e Apelit u pajtua në tërësi me vlerësimin e Gjykatës Themelore, duke konstatuar se, mbështetur në informatat e pranuar nga autoritetet turke, parashkrimi i ekzekutimit të dënimit të shqiptuar kundër parashtruesit të kërkesës arrihet me 4 maj 2028.
  116. Ndërsa, përkitazi me këtë pretendim, Gjykata rikujton se përmes Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës për parashkrim të ekzekutimit të dënimit, të paraqitur përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se lidhur me parashkrimin e ekzekutimit të dënimit të shqiptuar ndaj parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme i është referuar ligjit të dy shteteve. Fillimisht, Gjykata Supreme theksoi se, sipas ligjit të Turqisë, parashkrimi i ekzekutimit të dënimit në fjalë arrihet me kalimin e 10 (dhjetë) viteve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit dënues. Më pas, duke iu referuar KPRK-së së vitit 2012, konstatoi se *“Konform nenit 108 paragrafi 1.5 të KPRK-së, i cili ka qenë fuqi kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet pasi të kenë kaluar (3) vjet nga dënimi me mbi 1 (një) vit burgim, ndërsa konform nenit 110 paragrafi 6 të KPRK-së parashkrimi i ekzekutimit të dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.”* Ndërsa sa i përket afatit relativ, Gjykata Supreme kishte konstatuar se parashkrimi i tillë nuk rrjedh gjatë kohës kur kryerësi kërkohet me urdhër arrest.
  117. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se procedura që kishte rezultuar në nxjerrjen e Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme ndërlidhej me dënimin e parashtruesit të kërkesës për shpalljen fajtor të parashtruesit të kërkesës për kryerjen e veprës penale *“Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës”* sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk, për të cilin, Gjykata Themelore Penale Nr. 5 e Karsiyaka në Izmir i kishte shqiptuar dënim me 2 (dy) vite burgim. Gjykata vëren se më 4 maj 2018 vendimi i lartcekur ishte bërë i formës së prerë.
  118. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet KPRK-së i cili në (i) nën-paragrafin 1.5 të paragrafit 1 të nenit 108 që përcakton se përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Kod, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet pasi të kenë kaluar tri (3) vjet nga dënimi me mbi një (1) vit burgim; (ii) në paragrafin 4 të nenit 110 përcakton se afati i parashkrimit ndërpritet me çdo veprim të filluar nga organi kompetent me qëllim të ekzekutimit të dënimit; (iii) në paragrafin 6 të nenit 110 përcakton se ekzekutimi i dënimit ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.
  119. Mbi bazën e dispozitave të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës ishte dënuar me vendim të formës së prerë më 4 maj 2018. Në ndërkohë, autoritet turke kishin bërë kërkesa për ekstradim të parashtruesit. Ndërsa Gjykata e Apelit kishte vendosur me vendim të formës së prerë për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me veprën penale të cekur më lart, përmes Aktvendimit [PN. nr. 157/2024] të 7 shkurtit 2024. Prandaj, rezulton se nga dënimi i parashtruesit, deri në nxjerrjen e Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, të 7 shkurtit 2024, nuk kishte kaluar afati gjashtë (6) vjeçar për parashkrim absolut, as sipas legjislacionit të Kosovës.
  120. Nga dosja e lëndës po ashtu rezulton se kundër parashtruesit të kërkesës është e hapur procedura penale me shenjë [2021/161 Esas] pranë Gjykatës Themelore për Krimet e



- Rënda nr.3-Izmir si dhe procedura penale me shenjë [2020/500 Esas] pranë Gjykatës Themelore për Krimet e Rënda nr. 2-Stamboll, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” nga neni 188/3 dhe “*Prodhim dhe tregtim i lëndëve narkotike ose piskotrope*” në bashkëkryerje, nga nenet 188/3 dhe 188/5 të Kodit Penal Turk, lidhur me të cilën është kërkuar ekstradimi.
121. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se si zbatimi i ligjit përkitazi me parashkrimin e ekzekutimit nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e shkallës më të ulët është qartazi i gabuar apo arbitrar dhe që mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” për të.
  122. Gjykata po ashtu konsideron se Gjykata Supreme, por edhe gjykatat e shkallës më të ulët i janë përgjigjur pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme ka arritur në këtë përfundim pasi që ka shqyrtuar arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore kur konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës, ankesën e tij të parashtruar në Gjykatën e Apelit, arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit si dhe kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, të dorëzuar pranë Gjykatës Supreme.
  123. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës thekson se ekstradimi i tij shkel nenin 5 (Ndalimi i dëbimit ose i kthimit (Non -refoulement)) të Ligjit për Azil, me arsyetimin se i njëjti ndalon dëbimin apo kthimin e aplikuesit në kufijtë e territorit ku do t’i kërcënohet jeta apo liria e tij për arsye të racës, religjionit, përkatësisë kombëtare anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo bindjeve të tij politike.
  124. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht vëren se nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën e tij për azil pranë autoriteteve përkatëse në vitin 2023, përkatësisht 5 (pesë) vite pas hyrjes në Republikën e Kosovës dhe 2 (dy) vite pas arrestimit të tij nga autoritetet policore. Lidhur me këtë procedurë, Gjykata thekson se gjykatat e rregullta, dhe më specifikisht Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr.157/2024] kishte theksuar se procedurat përkitazi me kërkesën për azil ishin ende duke u zhvilluar dhe se në rastin e tij ende “*nuk kemi të bëjmë më një vendim të formës së prerë nga organi administrativ*”.
  125. Lidhur me këtë, Gjykata ka trajtuar çështjen e rrezikut për mundësinë që me rastin e kthimit të tij ai të përballë me rrezikun që t’i nënshtrohet trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së, më lart në këtë Aktvendim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
  126. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ashtu siç është sqaruar më lart, largimi i personit që ka paraqitur aplikacionin e azilit, për vendin e tyre të origjinës, do të ishte në kundërshtim më nenin 3 të KEDNJ-së nëse autoritetet shtetërore, kanë dështuar për të vlerësuar paraprakisht çdo pretendim të rrezikut për keqtrajtim në vendin e origjinës.
  127. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet edhe nenit 6 (Qëllimi) të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar që përcakton se  
“[...]”  
2. *Personat e mëposhtëm nuk mund të ekstradohen kundër vullnetit të tyre:*

[...]

2.2. *personat të cilëve iu është dhënë azil politik në Republikën e Kosovës;*

[...]

3. *Statusi i shtetasit të Republikës së Kosovës ose të një refugjati politik përcaktohet nga koha e pranimit të kërkesës për ekstradim.*”

128. Gjykata lidhur me këtë sjellë në vëmendje faktin se parashtruesi i kërkesës, përkitazi me Vendimin [Nr. 99/2024] e 2 majit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë përkitazi me lejimin e ekstradimit të tij nga Republika e Kosovës për në Republikën e Turqisë, ka inicuar procedura gjyqësore dhe të cilat nuk janë objekt i shqyrtimit përmes kërkesës aktuale, pasi ai nuk i ka kontestuar ato para Gjykatës.
129. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje kushtetuese janë pretendime qartazi të pabazuara në baza kushtetuese për shkak të mungesës së dukshme dhe evidente të shkeljes, ashtu siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
130. Në këtë kuptim Gjykata rithekson se përkitazi me parashtruesin e kërkesës janë duke u zhvilluar edhe procedura tjera gjyqësore, përfshirë procedurën përkitazi me Vendimin [Nr. 99/2024] e Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin e tij nga Republika e Kosovës për në Republikën e Turqisë dhe procedurën përkitazi me kërkesën e tij për azil. Megjithatë, para Gjykatës nuk kanë qenë objekt shqyrtimi këto procedura pasi të njëjtat nuk janë kontestuar nga para Gjykatës nga parashtruesi i kërkesës. Prandaj, vendimmarrja e Gjykatës përkitazi me kërkesën e tanishme nuk e paragjykon vendimmarrjen e institucioneve përkatëse përkitazi me ato procedura.

### ***(iii) Lidhur me pretendimin për caktimin e masës së paraburgimit***

131. Gjykata, fillimisht, rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës në mënyrë shprehimore konteston caktimin e masës së paraburgimit të shqiptuar kundër tij përmes Aktvendimit [PK. nr. 117/21] të 11 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore.
132. Përkitazi me këtë pretendim, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret, si çështje paraprake, duhet të vlerësojë: (i) nëse ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është dorëzuar brenda afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe pikën (c) të paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës; dhe (ii) cili është “vendimi i fundit” në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës në ndërlidhje me rrjedhjen e afatit ligjor katër (4) mujor nga neni 49 i Ligjit në lidhje me këtë pretendim specifik.
133. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson edhe një herë pretendimin e parashtruesit të kërkesës për tejzgjatje të masës së paraburgimit të shqiptuar kundër tij, përkatësisht deri në ekstradimin e tij tek autoritet e Turqisë. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës thekson se meqenëse kërkesa e tij për azil është në procedurë para Gjykatës Themelore dhe mund të zgjasë me vite, masa e paraburgimit e shqiptuar përmes Aktvendimit [PK. nr. 117/21] të 11 gushtit 2021 të Gjykatës Themelore duhet t’i zëvendësohet me një masë më të butë ose me qëndrim në Qendrën për Azilkërkues në Lipjan.
134. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata fillimisht thekson se nga shkresat e lëndës rezulton se lidhur me caktimin e masës së paraburgimit, “vendim i fundit” është Aktvendimi [PK. nr. 117/21] i 11 gushtit 2021 i Gjykatës Themelore dhe Aktvendimi [PN. nr. 784/2021] i 24

gushtit 2021 i Gjykatës së Apelit, përmes të cilit ishte vërtetuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar në Gjykatë më 7 gusht 2024, respektivisht kërkesa është dorëzuar pas afatit ligjor katër (4) mujor.

135. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajve, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, i shërben sigurisë juridike dhe siguron që çështjet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe parandalon autoritetet dhe personat e tjerë të afektuar që të mos mbahen në një gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë (shih, rastet e Gjykatës [KI61/23](#), parashtruese *Hedie Bylykbashi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 25 majit 2023, paragrafi 33; [KI24/23](#), parashtrues *Sami Nuredini*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 prillit 2023, paragrafi 21; si dhe rastin e GJEDNJ-së, [Lekić kundër Sllovenisë](#), nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 65). Ky rregull gjithashtu i jep kohë parashtruesit potencial nëse do të paraqes një kërkesë në Gjykatë, dhe, nëse po, të vendosë për argumentet specifike që do i paraqes si dhe rrjedhën e fakteve, pasi që me kalimin e kohës bëhet i vështirë shqyrtimi i çështjeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës (shih, rastin e Gjykatës [KI115/20](#), parashtrues *Muharrem Rama*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 nëntorit 2021, paragrafët 55-56; si dhe rastin e GEDNJ-së, [Sabri Güneş kundër Turqisë](#), nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafët 52 dhe 55).
136. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me këtë pretendim nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe pikës (c) të paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës.

**(iv) Lidhur me kërkesën për vendosje të masës së përkohshme ndaj Vendimit [Nr. 99/2024] të Ministrisë së Drejtësisë**

137. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht anulimin e Vendimit [Nr. 99/2024] të 2 majit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë për ekstradimin e tij nga Republika e Kosovës për në Republikën e Turqisë, me arsyetimin se rrezikon t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues, të ndaluar sipas nenit 3 (Ndalimi i torturës) të KEDNJ-së.
138. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk e konteston procedurën para Ministrisë së Drejtësisë por konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 184/2024] e 21 marsit 2024 të Gjykatës Supreme. Përkitazi me këtë të fundit, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme kishte vërtetuar vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me lejimin e ekstradimit të parashtruesit të kërkesës në Turqi për veprën penale "Vjedhje e sendit të marrë në mbrojtje brenda ndërtesës" sipas neneve 142/1-b, 35/1-a, b, c, d dhe e të Kodit Penal Turk. Ndërkaq, Ministria e Drejtësisë përmes Vendimit [Nr. 99/2024] të 2 majit 2024 dha pëlqimin për ekstradimin e parashtruesit të kërkesës për në Turqi, për shkak të veprave penale "Falsifikim i dokumenteve zyrtare" nga neni 204/1 dhe "Vjedhje e sendit të vendosur në ruajtje" nga neni 142/1-B të Kodit Penal Turk.
139. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative padi për anulimin e Vendimit [Nr. 99/2024] të 2 majit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të tij, me arsyetimin se në rast të ekstradimit, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Në lidhje me këtë, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për

Çështje Administrative përmes Aktvendimit [A. nr. 1980/2024] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të Ministrisë së Drejtësisë, me arsyetimin se i njëjti nuk kishte ofruar prova bindëse, aktvendim i cili më pas u vërtetua nga Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AA. nr. 574/2024] të 13 qershorit 2024.

140. Gjykata më sipër ka konstatuar se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme. Prandaj, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

### Përfundim

141. Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se (i) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje kushtetuese, si rezultat i vendimeve të kontestuara të cilat kanë vendosur për ekstradimin e parashtruesit, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese; ndërsa (ii) pretendimi i parashtruesit të kërkesës përkitazi me caktimin e masës së paraburgimit është dorëzuar jashtë afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
142. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa në tërësi duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet në nenin 49 të Ligjit, pikën (c) të paragrafit (1) dhe paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 47 të Ligjit dhe rregullave 34 (2), 45 dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 25 shtator 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenin 20 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Jeton Bytyqi



  
Gresa Caka-Nimani